



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.139/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevcu dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Fitore Isufi duke vendosur përkritazi me ankesat e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterëve në afërsi të shkollës, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohen** si të pabazuara ankesat ZL.Anr. 139/2017 dhe ZL.Anr. 140/2017, të parashtruara nga BIRN me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që t’iu shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga BIRN me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se posterit i kandidatit për kryetar të Komunës së Pejës Fatmir Gashi, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur jashtë objektit të shkollës së Muzikës “Halit Kasapolli” në Pejë, si dhe posterit i kandidatit për Kryetar të Komunës së Pejës nga radhët e subjektit politik LDK, Gazmend Muhaxheri po ashtu është vendosur po në të njëjtin vend. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, nga ana e subjektit politik LDK dhe AAK, duke pretenduar se subjektet në fjalë kanë shkelur këtë nen në momentin që kanë vendosur poster në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur dy CD lidhur me rastet në fjalë.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.139/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se ankesa e BIRN është e pa bazuar për faktin se nga video-incizimi të cilin pala ankuese e ka bashkangjitur, “Billbordi” në të cilin është vendosur fotoja e kandidatit për kryetar të Komunës së Pejës, është i vendosur në atë lokacion me leje të komunës (dhe jo nga LDK) dhe është dedikuar ekskluzivisht për reklamime të tilla, gjatë fushatës, kryesisht reklamime politike, jashtë

fushatës më tepër komerciale. Për më tepër subjekti politik LDK kërkon që ankesa në fjalë të hidhet poshtë si e pa bazuar. Ndërsa subjekti politik AAK, në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2017, thekson se vendosja e billbordit në Pejë afër shkollës së muzikës “Halit Kasapolli” është në pajtueshmëri të plotë me kodin zgjedhor, hapësira reklamuese nuk është në oborrin e shkollës, në pronësi të shkollës, në rrethojat e shkollës, përpara hyrjes së shkollës ose në kënd ku shihet prej shkollës as anasjelltas. Ndër të tjera subjekti politik AAK thekson se nga materiali që u është ofruar në CD tregon se nuk ka shkelje të kodit zgjedhor.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesat janë të pa pabazuara**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjekteve politike LDK dhe AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye e posterat e vendosur në afërsi të shkollës, gjatë fushatës nuk është e ndaluar, por e ndaluar është dhe duhet të largohen në largësi prej 100 metra, 24 orë para hapjes së Qendrës së Votimit në ditën e votimit. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesave, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesa në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL. Anr.139/2017 më datën 10.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyhdi Haziri**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.